



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 06 Tetor 2023

Nr: 794

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT REGJISTRUAR ME NR. 374 ID, TË Z. IVI KASO, NDAJ Z. MARIIGLEN DISHA KANDIDAT PËR KRYETAR PËR BASHKINË LIBRAZH DHE NDAJ Z. QAMIL MEMA, DREJTOR I SHKOLLËS 9 VJEÇARE SPATHAR LIBRAZH D, DHE DENONCIMIT ME NR. 390 ID, TË Z. EDMOND SPAHO, DEPUTET I KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 06 Tetor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Z. Edmond Spaho, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë
Z. Ivi Kaso, Sekretar për Çështjet Ligjore

SUBJEKT: Z. Mariglen Disha, kandidat për kryetar për bashkinë Librazhd;
Z. Qamil Mema, drejtor i shkollës 9-vjeçare Spathar, Librazhd;
Z. Gëzim Topçiu, kryetar dhe njëkohësisht kandidat për kryetar për Bashkinë Maliq;
Zj. Burbuqe Beshiri, administratore e Njesisë Administrative Libonik, Maliq;
Z. Eri Rustemi, Nënkyetar i bashkië Maliq;
Z. Kreshnik Azo, administrator i Njesisë Administrative Pojan, Maliq;
Z. Eridjon Rustem, Nënkyetar i Bashkisë Maliq;
Z. Rediljan Shkëmbi, punonjës në bashkinë Maliq;
Zj. Uerda Hoxhaj, punonjëse në bashkinë Maliq;

Zj. Klevisa Kupe, punonjëse në bashkinë Maliq;
Z. Julian Avdolli, punonjës në bashkinë Maliq;

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka administruar denoncime për të cilat pretendohet se ka patur shkelje administrative të parashikimeve ligjore.

Denoncimet janë marrë në formë shkresore, nëpërmjet provave link apo provave fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 2 (dy) denoncime nëpërmjet provave të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve/denoncimeve.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike për të cilat nga pala denoncuese pretendohet se janë kryer shkelje administrative.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike, e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- 1- Denoncim i regjistruar me nr. 374 ID ndaj Z. Mariglen Disha, Kandidat për kryetar në bashkinë Librazhd, I subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë si dhe z. Qamil Mema, drejtor i shkollës 9-vjeçare Spathar, Librazhd, për 1 (një) veprimtari, për të cilën pretendohet si vijon:

"Vërehet në mënyrë të përsëritur përdorimi i ambienteve të institucioneve arsimore për aktivitete të fushatës elektorale. Informacionet vijnë edhe nga Librazhdi ku kandidati i PS për këtë bashki ka urdhëruar hapjen e shkollës dhe përdorimin e ambienteve për takime elektorale."

Më datë 4.5.2023, Zyrës Vendore Arsimore Librazhd i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike, dhe institucioni në vijim informon se *"ZVAP Librazhd në zbatim të shkresës me nr. 730/1 prot., datë 10.02.2023 të MAS "Mbi zbatimin e përcaktimeve ligjore për institucionet arsimore" vuri në dijeni institucionet arsimore në varësi të saj për zbatimin e këtyre përcaktimeve ligjore me anën e shkresës zyrtare me nr 274/1 prot.datë 13.02.2023 si dhe në mbledhjen e datës 27.02.2023 me të gjithë drejtuesit e institucioneve arsimore ju janë rikujtuar shkresat e sipërpërmendura të MAS dhe ZVAP Librazhd. Nga informacioni që ju përcillni nëpërmjet email-it rezulton se ky aktivitet i kryer nga kandidati për kryetar bashkie z. Mariglen Disha është bërë në territorin e një shkolle 9-vjeçare. ZVAP Librazhd nuk ka patur as informacion dhe as njoftim për zhvillimin e këtij aktiviteti politik. Nga fotoja rezulton se në takim nuk ka pjesëmarrje të stafit mësimor dhe të nxënësve të këtij institucioni arsimor."*

Lidhur me sa u deklarua nga institucioni, për një hetim më të plotë dhe të gjithanshëm u kërkuar informacion më i detajuar ku në vijim zyra vendore arsimore informoi se: *"Ambientet ku është zhvilluar aktiviteti nga kandidati për kryetar bashkie z. Mariglen Disha është shkolla*

filllore Gurkuqe, shkollë vartëse e shkollës 9-vjeçare Spathar. Titullari i shkollës 9-vjeçare Spathar është z. Qamil Mema. Shkolla 9-vjeçare Spathar ka që në vitin 2014 që është pjesë e projektit të shkollave Qendër Komunitare ku vizion i saj është "Transformimi i shkollës në vendin ku realizohet partneriteti: shkollë, familje dhe komunitet duke shfrytëzuar të gjitha burimet që ofron shkolla, familja dhe komuniteti". Ambientet e jashtme të shkollës janë të rrethuara, por pas procesit mësimor shkolla nuk ka në dispozicion roje të objektit."

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqit asnjë nga palët në proces.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, nëpërmjet vendimit nr. 674, datë 26.06.2023 "Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 374 ID, 375 ID, 385 ID, 390 ID, 436 ID dhe 439 ID, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023", ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 374 ID.

Pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27 Korrik 2023 nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimev përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në përgjigjë të kërkesës sonë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare ndër të tjera bën me dije se "Takimi i zhvilluar nga kandidati për kryetar bashkie që i përkiste subjektit politik Partia Socialiste, ishte bërë në oborrin e shkollës 9-vjeçare Gurkuqe, varëse e shkollës 9-vjeçare Spathar. Nga informacionet e marra ka rezultuar se ky takim është zhvilluar më orët e vona të pasdites dhe pa dijeninë e ZVAP Librazhd. Gjithashtu rezulton se në këtë takim nuk ka pjesëmarrje të stafit të kësaj shkolle vartëse, i përbërë nga dy mësues dhe 13 nxënësit e saj".

Në vijim të hetimit administrativ, palët në procesin administrativ, u njoftuan për të marrë pjesë në seancën publike të datës 06.10.2023, për të dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në seancë publike u paraqit z. Fatmir Duro, në cilësinë e përfaqësuesit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Librazhd, si dhe z. Qamil Mema drejtor i shkollës 9-vjeçare Spathar, Librazhd, të cilën i qëndruan pretendimeve të tyre depozituar në rrugë elektronike.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve rezultoi e provuar nga pamjet fotografike si dhe deklarimeve të Zyrës Vendore Arsimore Librazhd se veprimtaria me karakter publik është kryer në ambientin e një institucionit arsimor publik, konkretisht në ambientet e jashtme të shkollës filllore Gurakuq, shkollë vartëse e shkollës 9-vjeçare Spathar.

Nga sa evidentohet nga deklarimi i mbajtur në posimin publik në faqen zyrtare në "facebook" të kandidatit z. Mariglen Disha, vihet re se kemi të bëjmë me një takim me karakter elektoral

Data: 06 Tetor 2023 Nr: 794
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 374 ID, 390 ID, për shkelje administrative"

ku kandidati shprehet si vijon: *“Në lagjen Gurrë Kuqe në fshatin Spatharë me banorët biseduam për infrastrukturën rrugore, kanalin vaditës, dhe padyshim mbështetje për familjet që u është dëmtuar banesa nga fatkeqësi natyrore!*

#MeNjerëzit #PërNjerëzit #LibrazhdiSkaKohëPërPushim #VetëmPËRPARA #KurrëMëMbrapa #KrenarpërPS”

Takimi ka qartësisht përmbajtur elektorale ku vërtetohet edhe qëllimin zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Rezultoi e provuar gjithashtu se kandidati për kryetar të bashkisë Librazhd, me zhvillimin e këtij aktiviteti elektoral në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Gurakuq”, fshati Spathar, Librazhd, konstaohet se **ka përdorur burime publike** në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore.

Në kuptim të nenit 172, pika 1 të Kodit Zgjedhor, subjektet zgjedhore ndëshkohen administrativisht në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, me parakushtin që subjekti zgjedhor, të ketë marrë dënim dhe pas marrjes dënim të mos ketë marra masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Në rastin objekt shqyrtimi, nuk u provua që subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, të jetë vënë në dënim. Gjithashtu nuk u provua se drejtori i shkollës është vënë në dënim të kryerjes së kësaj veprimtarie në oborrin e shkollës e cila është nën administrimin e tij. Nuk u provua që drejtorit të shkollës 9-vjeçare Spathar ti jetë marrë leje për kryerjen e kësaj veprimtarie publike elektorale.

Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, vlerësoj se në rastin e denoncimit **nr. 374 ID**, drejtori i shkollës 9-vjeçare “Spathar”, Librazhd, z. Qamil Mema si personi përgjegjës për administrimin e institucionit arsimor, nuk provohet që të ketë lejuar përdorimin nga kandidati për kryetar bashkie, të ambienteve të shkollës për qëllime zgjedhore.

Për sa më sipër vlerësoj se të ndodhur në këto kushte duhet të pushohet hetimi administrative si për kandidatin për kryetar në bashkinë Librazhd, po ashtu edhe për z. Qamil Mema drejtor i shkollës 9-vjeçare Spathar, Librazhd.

2- Denoncim regjistruar me nr. 390 ID ndaj Bashkisë Maliq për 1 (një) veprimtari, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 390 ID, me kërkues z. Edmond Spaho, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ku pretendohet si vijon:** *“Më datë 2 Maj 2023, ora 14:30, Kryeministri z. Edi Rama zhvilloi një takim elektoral në Bashkinë Maliq, Njësinë Administrative Maliq. Në takim ishin të pranishëm edhe Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi. Në takim ishin të pranishëm në një masë të madhe*

punonjësit e bashkise Maliq, brenda orarit zyrtar. Ky veprim, pjesëmarrja e administratës publike në takime elektorale brenda orarit zyrtar është në kundërshtim flagrant me parashikimet e nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor.

Emrat dhe funksioni i secilit prej punonjësve të pretenduar nga denoncuesi janë si vijon:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------|
| <i>1. Administrator, Libonik</i> | <i>Burbuqe Beshiri</i> |
| <i>2. Nënkyetar i bashkisë</i> | <i>Eri Rustemi</i> |
| <i>3. Adminstrator, Pojan</i> | <i>Kreshnik Azo</i> |
| <i>4. Agronom</i> | <i>Redilian Shkembali</i> |
| <i>5. Punonjëse bashkie</i> | <i>Uerda Hoxhaj</i> |
| <i>6. Punonjëse bashkie</i> | <i>Klevisa Kupe</i> |
| <i>7. Punonjëse bashkie</i> | <i>Sonila Lico</i> |
| <i>8. Punonjës bashkie</i> | <i>Juli Avdoli"</i> |

Më datë 4.5.2023, bashkisë Maliq i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike, dhe institucioni në vijim informon se “Së pari ju informojmë se nga 8 (tetë) personat e listuar në emailin tuaj, 7(shtatë) prej tyre janë punonjës të Bashkisë Maliq. Personi nr. 7 i listuar në email znj. Sonila Lico nuk është punonjëse e Bashkisë Maliq.

Përsa i përket punonjësve si më poshtë:

- Zj. Burbuqe Beshiri në funksion Administrator e Njesisë Administrative Libonik;*
- Z. Kreshnik Azo në funksionin Administrator i Njesisë Administrative Pojan;*
- Z. Eridjon Rustemi në funksionin e Nënkyetarit të Bashkisë Maliq;*

Sqarojmë se personat e sipërpërmendur janë funksionar politik, që emërohen dhe shkarkohen nga vetë kryetari i bashkise sipas ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ushtrojnë funksione në bazë të vendimmarrjes së tij (neni 59, 65 i ligjit “Për Vetëqeverisjen Vendore”) dhe nuk kryejne funksione publike. Funksionarët politik në ndryshim nga punonjësit e administratës shtetërore (burimet njerëzore) janë pjesë e aktivitetit politik që zhvillon kryetari i bashkisë. Përcaktimet e nenit 91, 92 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë i referohen me burime njerëzore punonjësve të administratës shtetërore qoftë me status apo pa status nëpunësi civil, dhe jo funksionarëve politik.

Përsa i përket tre punonjësve të tjerë:

- 1. Rediljan Shkëmbi;*
- 2. Uerda Hoxhaj;*
- 3. Klevisa Kupe;*

Sqarojmë se këta punonjës bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 568 datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavaruara dhe njësitet e vetëqeverisjes vendore”, Kreu III “Pushimet”, pika 3, kanë marrë lejen vjetore sipas kërkesave të tyre të miratuara nga eprorët dhe kryetari i bashkisë që në datën 28.4.2023. Këta punonjës kanë qenë me leje vjetore sipas kërkesave të tyre. Bashkangjitur do të gjeni kopje të kërkesave të 3 punonjësve përkatës për të marrë lejen vjetore të vitit 2023.

Përsa i përket punonjësit Z. Julian Avdolli pretendimi se ai ka qenë pjesë e mitingut nëpërmjet një fotoje të tij të shkrepur në rrugë duke ecur, nuk qëndron. Punonjësi është parë duke ecur në rrugë dhe është ngritur pretendimi se ka qenë pjesë e mitingut të zhvilluar në datën 2.5.2023. Z. Julian Avdolli është i punësuar në pozicionin “Agronom” dhe nga vetë karakteri i punës i duhet që një pjesë të madhe të funksioneve të tij ti kryejë në terren për të parë problematikat konkrete të punës.”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Maliq.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, nëpërmjet vendimit nr. 674, datë 26.06.2023 “Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 374 ID, 375 ID, 385 ID, 390 ID, 436 ID dhe 439 ID, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 390 ID.

Pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27 Korrik 2023, nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në përfundim të afatit për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për bashkëpunim.

Në vijim të hetimit administrativ, palët në procesin administrativ, u njoftuan për të marrë pjesë në seancën publike të datës 06.10.2023, për të dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në seancë publike nuk u paraqit asnjë prej palëve të njoftuara.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve në denoncimin e regjistruara me nr. **390 ID**, konstatoj se:

Punonjësit e administratës shtetërore kanë të garantuar kushtet e nevojshme për moscenimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese për të ushtruar pa ndikim lirinë e shprehjes dhe/ose për të marrë pjesë në veprimtari politike, por brenda kufizimeve dhe ndalimeve, pa cënuar funksionet publike dhe shërbimin ndaj qytetarëve.

Nga provat dhe faktet e administruara, nuk provohet qartësisht shkelja e pretenduar nga denoncuesi dhe nuk u administruan prova të tjera të cilat faktonin, përdorimin e detyruar të punonjësve në takimin elektorale apo pjesëmarrjen e tyre gjatë orarit zyrtar të punës.

Në këto kushte vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrative për shkak të kushteve në të cilat ndodheshin subjektet e denoncuara.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e shqyrtimit administrative ndaj:
 - Z. Mariglen Disha, kandidat për kryetar në bashkinë Librazhd;
 - Z. Qamil Mema, drejtori i shkollës 9-vjeçare “Gurakuq”, Spathar, Librazhd;
 - Zj. Burbuqe Beshiri, administratore e Njesisë Administrative Libonik, Maliq;
 - Z. Eri Rustemi, Nënkyetar i bashkië Maliq;
 - Z. Kreshnik Azo, administrator i Njesisë Administrative Pojan, Maliq;
 - Z. Eridjon Rustem, Nënkyetar i Bashkisë Maliq;
 - Z. Rediljan Shkëmbi, punonjës në bashkinë Maliq;
 - Zj. Uerda Hoxhaj, punonjëse në bashkinë Maliq;
 - Zj. Klevisa Kupe, punonjëse në bashkinë Maliq;
 - Z. Julian Avdolli, punonjës në bashkinë Maliq.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Kopje: 4

Afati i ruajtjes: 5

vjet

Punoi:

I.Horanliu _____

M.Koja _____

A. Lamçe _____

Y.Merkaj _____

Ilirjan CELIBASHI

Data: 06 Tetor 2023 Nr: 794
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 374 ID, 390 ID,
për shkelje administrative”